

02.02.2022
Ora 17:08

RENDI I DITËS


Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesave të disa partive politike për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Staf i KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:** **PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)**
- **OJQ:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Mirëmbërëma! Atëherë në seancën e sotme publike kemi në rend dite shqyrtimin e kërkesave të disa partive politike për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022. Atëherë, në rend dite janë kërkesat e Partisë Socialiste, Partia Demokratike, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia Lëvizja e Re, Partia Fryma e Re Demokratike, Partia Kristian Demokrate, Partia Demokristiane, Partia e Reformave Demokratike të Shqipërisë, Partia Bashkimi Demokrat, Partia Lëvizja e Legalitetit, Partia Balli Kombëtar Demokrat. 11 kërkesa për regjistrim. Mirë, atëherë, fjala për Sekretarin, për të relatur projektvendimet. Mund të bësh një relatum të përgjithshëm në lidhje me përmbushjen e detyrimeve sipas Kodit Zgjedhor dhe akteve të KQZ-së nga ana e partive politike, të cilat kanë kërkuar të regjistrohen si subjekte zgjedhore në këto zgjedhje. Po!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.02.2022*

Z. Y. Merkaj: Presidenti i Republikës ka dekretuar datën 6 mars për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje. Referuar nenit 64 të Kodit Zgjedhor, Partia Socialiste nëpërmjet sekretarit të Përgjithshëm, zotit Damian Gjijnuri me autorizim nr. 14, datë 25.01.2022;

Partia Demokratike nëpërmjet kryetarit zotit Lulzim Basha;

Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, nëpërmjet kryetarit të saj, zonjës Monika Kryemadhi;

Partia Lëvizja e Re, nëpërmjet kryetarit zotit Arian Galdini;

Partia Fryma e Re Demokratike, nëpërmjet kryetarit zotit Sali Shehu;

Partia Kristian Demokrate, nëpërmjet kryetarit zotit Dhimitër Muslia;

Partia Demokristiane e Shqipërisë, nëpërmjet kryetarit zotit Nard Ndoka;

Partia e Reformave Demokratike të Shqipërisë, nëpërmjet kryetarit zotit Krenar Yçi;

Partia Bashkimi Demokrat, nëpërmjet kryetarit zotit Ylber Valteri;

Partia Lëvizja e Legalitetit, nëpërmjet kryetarit zotit Shpëtim Axhami dhe

Partia Balli Kombëtar Demokrat, nëpërmjet kryetarit zotit Artur Rroshi, kanë paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t'u regjistruar si subjekte zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore, që zhvillohen në datën 6 Mars 2022. Kërkesat e paraqitura respektojnë afatin kohor të parashikuar në pikën 7, të vendimit nr. 2, datë 22.01.2022 të Komisionit Rregullator "Për miratimin e disa afateve proceduriale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, që zhvillohen më datën 6 Mars 2022". Pas verifikimit përkatës konstatohet se kërkesat e paraqitura dhe dokumentacioni është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, pika 2 të Kodit Zgjedhor dhe 92/2, pika 2 të Kodit Zgjedhor dhe secila propozohet që të regjistrohet si subjekt

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.02.2022*

zgjedhor. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, përfaqësuesit e partive politike, përfaqësuesi i Partisë Demokratike, në lidhje me projektaktin në tërësi?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Celibashi! Jemi njohur me projektvendimin sa i përket regjistrimit si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjeshme vendore, të datës 6 Mars 2022 të Partisë Demokratike, të cilën ne e përfaqësojmë me kryetar zotin Lulzim Basha dhe e gjejmë këtë projektvendim në përputhje me të gjitha parashikimet ligjore, si në formë dhe në përmbajtje, jemi dakord. Nuk kemi asnjë objeksion!

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Faleminderit zoti Kryetar! Edhe ne jemi njohur me projektvendimet që do të miratohen nga ana juaj. Janë projektvendime të karakterit të procedurës të parashikuara në ligj, të cilat brenda një afati të caktuar miratohen. Nuk kemi ndonjë kundërshtim në parim. LSI ka sjellë brenda afatit ligjor kërkesën përkatëse, të cilën ju do ta miratoni si pikë e tretë e këtij rendi dite, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëherë, meqenëse jemi dakord me projektaktet, i miratojmë ato sipas sipas drafteve të propozuara.

Pra, përfundimisht miratohet regjistrimi i Partisë Socialiste të Shqipërisë si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet e 6 marsit 2022.

Vendimi nr. 32

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.02.2022*

Miratohet regjistrimi i Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor për këto zgjedhje.

Vendimi nr. 33

Miratohet regjistrimi i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim si subjekt zgjedhor për këto zgjedhje dhe vendosim vetëm Lëvizja Socialiste për Integrim, nuk e keni partia më duket? S'e mbaj mend në zgjedhjet e 25 prillit është vetëm, Lëvizja Socialiste për Integrim. Megjithatë e verifikojmë me dokumentacionin.

Vendimi nr. 34

Miratohet regjistrimi si subjekt zgjedhor për këto zgjedhje i Partisë Lëvizja e Re.

Vendimi nr. 35

Miratohet regjistrimi si subjekt zgjedhor për këto zgjedhje i Partisë Fryma e Re Demokratike.

Vendimi nr. 36

Miratohet regjistrimi si subjekt zgjedhor për këto zgjedhje i Partisë Kristian Demokrate.

Vendimi nr. 37

Miratohet regjistrimi si subjekt zgjedhor i Partisë Demokristiane. **Vendimi nr. 38**

Miratohet regjistrimi si subjekt zgjedhor i Partisë Reforma Demokratike të Shqipërisë.

Vendimi nr. 39

Miratohet regjistrimi si subjekt zgjedhor i Partisë Bashkimi Demokrat.

Vendimi nr. 40

Miratohet regjistrimi si subjekt zgjedhor i Partisë Lëvizja e Legalitetit.


Vendimi nr. 41

Dhe e fundit, miratohet regjistrimi si subjekt zgjedhor i Partisë Balli Kombëtar Demokrat.

Vendimi nr. 42

Çështje të tjera në rendin e ditës? Në lidhje me këtë? S'kemi! Atëherë, para se ta përfundoj, sikurse është e parashikuar dhe në aktin përkatës të KQZ-së, do të duhet që brenda 24 orëve nga ky moment, partitë politike kanë të drejtën për të paraqitur kërkesën për t'u regjistruar si koalicion, dy ose më shumë parti politike. Pra, afati

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.02.2022*

përfundon nesër, brenda 24 orëve, sepse kështu e ka përcaktuar norma rregulluese që kërkesat të paraqiten jo më vonë se 24 orë nga momenti kur është marrë vendimi për regjistrimin si subjekt zgjedhor të partive politike, faleminderit! Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit, zoti Celibashi! Në fakt, duke qenë se u zhvillua kjo mbledhje, shfrytëzoi rastin të adresoj dhe një çështje që për ne është problematike. Besoj jo vetëm ne, por mbase dhe opinioni publik më gjerë, është njohur ditët e fundit që në media ka qarkulluar një lajm sa i përket Bashkisë Durrës. Kjo bashki ka marrë një vendim për të shpërndarë grantet, fondet e rindërtimit për 526 familje, që variojnë nga 100 mijë lekë deri në 500 mijë lekë të reja. Ju e dini zoti Celibashi, që ka qenë një shqetësim madhor që Partia Demokratike ka ngritur në mënyrë të vazhdueshme, përdorimin e fondeve dhe asetëve publike për qëllime elektorale dhe zgjedhore. Prandaj duke qenë se ekzistojnë në fakt, dyshime të arsyeshme që dhe këto grante po shpërndahen pikërisht në prag të zgjedhjeve të 6 marsit në Bashkinë Durrës, ne kërkojmë nga ana juaj që edhe për shkak të atyre që kanë qarkulluar në media, por edhe për shkak të këtij komunikimi, të fillohet një hetim administrativ për të verifikuar plotësisht në qoftë se, së pari, ky vendim është i vërtetë. Procedura që është ndjekur bie në kundërshtim me parashikimet që janë bërë nga Kodi Zgjedhor, konkretisht neni 91 dhe neni 92 i Kodit Zgjedhor dhe veçanërisht aktet nënligjore që ka nxjerrë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që ndalojnë përdorimin ose nxjerrjen e vendimeve, akteve ligjore apo nënligjore që kanë për qëllim të ofrojnë shpërblime për kategori të caktuara të qytetarëve? Sepse ne vlerësojmë, se ashtu siç ka ndodhur edhe në zgjedhjet e 25 prillit, në fakt sërish po përsëritet i njëjti fenomen dhe do të vijojë të përsëritet edhe më masivisht dhe ja ku jemi këtu. Të kemi mundësinë, të merren të gjitha masat në qoftë se është rasti,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.02.2022*

për të parandaluar shkelje të tilla që minojnë zgjedhjet e lira dhe të ndershme, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Atëherë, mbajtëm shënim kërkesën tuaj, e cila nuk ka nevojë të prezantohet me shkrim, pasi përsa kohë jeni përfaqësues i një subjekti politik, i cili ka legjitimitetin për të paraqitur kërkesa të tilla, e konsiderojmë të mjaftueshme nga pikëpamja procedurale. Do të fillojmë një proces të verifikimit të këtij pretendimi, duke i dërguar, qoftë Bashkisë Durrës, por ndoshta dhe institucioneve të tjera, kërkesë për informacion në lidhje mesa ju pretenduat, për të verifikuar nëse ekziston fakti dhe nëse lidhet me sjelljen e organeve apo e institucioneve publike në periudhë zgjedhore. Mirë, faleminderit!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Në qoftë se mundem, zoti Kryetar! Edhe unë ndaj të njejtin shqetësim me kolegun Logu. Fakti është që indiciet na kanë ardhur dhe ne përsa i përket këtij shqetësimi për Bashkinë Durrës. Tashmë kjo është një plagë e hapur prej vitesh, por është konsoliduar në vitin 2021, në zgjedhjet për Kuvendin, e cila është konfirmuar dhe nga rekomandimi përfundimtar i dhënë nga ana e OSBE/ODIHR-it. Unë do të ftoja të gjithë qytetarët që të denoncojnë raste abuzive, ku administrata shkon përtej asaj çfarë parashikon ligji, duke joshur, të themi, ata që janë banorët e asaj zone ku do votohet në datën 6 mars, të këtyre 6 bashkive. Duke joshur, duke intimiduar, duke trajtuar ndryshe, duke diskriminuar një pjesë të qytetarëve të saj, në mënyrë për të përfituar politikisht, në mënyrë të padrejtë, duke krijuar akte të karakterit që vijnë në kundërshtim me ligjin, qoftë administrativ, qoftë me ligjin penal në vetvete. Do të donim që administrata e KQZ-së dhe ju si Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pavarësisht se në vitin 2021, ju e dini fare qartë që nëpërmjet portalit të denoncimeve të dhëna nga ana e Partisë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.02.2022*

Demokratike, por dhe nga ana e Lëvizjes Socialiste për Integrim, ose anëtarëve dhe aktorëve të tjerë të subjekteve zgjedhore, ose të qytetarëve, ose çdo organizëm tjetër që kishte interes për të denoncuar këto fakte. Ka qenë një numër i konsiderueshëm denoncimesh, që ju i keni marrë në shqyrtim, për të cilat ju keni dalë dhe me vendim dënimi, të themi administrativ, për më shumë se dy, tre kryetarë bashkish, ose persona të ndaluar nga ligji elektorale, nga neni 91, 92, po ashtu dhe nga vendimi i Komisionit Rregullator, vendimi nr. 9. Kështu që sjellim në vëmendje që qytetarët duhet të bëhen bashkudhëtarë të një demokracie të brishtë. Duhet të denoncojnë çdo aferë, çdo intimidim që u bëhet, ose çdo joshje që u bëhet nëpërmjet pushtetit, nga persona të veshur me pushtet, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Në rregull, faleminderit për diskutimin! Kemi diskutime të tjera? Nuk kemi! Mirë, faleminderit, atëherë seanca mbyllet!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

